



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 1/121
Datë: 22.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Natyrës.
2. Obligohet Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 2/121
Datë: 22.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 3/121
Datë: 22.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Ripranim.
2. Obligohet Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 4/121
Datë: 22.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Krijohet komisioni ad-hoc për verifikimin e listave të veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, Invalidëve dhe Dëshmorëve.
2. Komisioni përbëhet nga 11 anëtar përfaqësues të:
 - a. Ish Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së;
 - b. Organizatës së Veteraneve të UÇK-së;
 - c. Përfaqësuesit e të gjitha ish Zonave Operative të UÇK-së;
 - d. Përfaqësues i ZKM-së;
 - e. Përfaqësues i ish TMK-së.
3. Obligohet Komisioni të filloj punën në prill 2010 dhe përfundoj brenda vitit 2010.
4. Komisioni do të bëj verifikimin dhe përfundimin e listave të Veteranëve të cilat do të dorëzohen në arkivat shtetërore, dhe do të jenë listat zyrtare të Ish pjesëtarëve të UÇK-së, Ushtarëve -Dëshmorëve të cilët kanë rënë gjatë periudhës së paraparë me ligj dhe po ashtu pjesëtarëve - Invalidëve të Luftës, të cilët janë plagosur apo lënduar gjatë periudhës së luftës së UÇK-së.
5. Për mbulimin e shpenzimeve të punës së komisionit, Qeveria ndanë mjete të nevojshme.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- OVL të UÇK-së
- SHFD të UÇK-së
- SHIL të UÇK-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 5/121
Datë: 22.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Të bëhet alokimi i parakohshëm i mjeteve në Ministrinë e Punëve të Brendshme (Agjencioni i Regjistrimit Civil) për kryerjen e obligimeve - furnizimin me Certifikata të Gjendjes Civile, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, pasi që këto mjete nuk kanë qenë të aprovuara në buxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Ligjin e Buxhetit Nr.03/-177 për vitin 2010.
2. Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të kontratës me nr. të prokurimit 237/09/012/111, ka obligim të furnizoj me Certifikata të gjendjes civile të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës.
3. Kostoja vjetore e furnizimit të komunave me certifikata të gjendjes civile arrin vlerën prej 700,000.00 (shtatëqind mijë) euro e cila pagesë vazhdon të realizohet nga Ministria.
4. Në procesin e rishikimit të buxhetit, mjetet e shpenzuara nga Ministria për furnizimit të komunave me certifikata të gjendjes civile, do të barten nga Komunat - kategoria e mallrave dhe shërbimeve, në buxhetin e Ministrisë gjegjësisht në kodin buxhetor të Agjencionit të Regjistrimit Civil - Departamenti i Regjistrimit dhe Gjendjes Civile 14800, në pajtim me ligjin për buxhetin për vitin 2010.
5. Shuma e cekur në piken 3. të këtij Vendimi përpjesëtohet për të gjitha komunat, në bazë të kërkesave për furnizim me certifikata të gjendjes civile.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 6/121
Datë: 22.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2010, mori

V E N D I M
Për fushëveprimin e Ministrisë së Integritit Evropian


Ministria e Integritit Evropian ka për mision drejtimin, bashkërendimin dhe monitorimin e procesit të integritit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian (tani e tutje: BE), duke siguruar hartimin e politikave të integritit, pajtueshmërinë e legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian, ndihmat financiare, informimin e publikut dhe ngritjen e kapaciteteve për këtë proces, Ministria e Integritit Evropian ka këto kompetenca:

1. Bashkërendon punën dhe monitoron aktivitetet e institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe angazhimet e ndërmarra prej tyre, në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asocimit;
2. Në bashkëpunim të ngushtë me institucionet tjera identifikon dhe definon prioritetet e Qeverisë së Kosovës me qëllim të zbatimit të kriterëve dhe obligimeve që dalin nga Procesi i Integritit Evropian;
3. Bashkërendon, monitoron dhe raporton për zbatimin e obligimeve të Kosovës nga procesi i Integritit Evropian;
4. Koordinon hartimin e dokumenteve strategjike të Qeverisë në procesin e Integritit Evropian si dhe siguron që këto dokumente të jenë në harmoni me dokumente tjera strategjike të Qeverisë;

5. Kërkon nga Ministritë e linjës dhe institucionet tjera qendrore përgatitjen dhe paraqitjen në afate të caktuara të dokumenteve, në funksion të procesit të Integrimit Evropian;
6. Në bashkëpunim të ngushtë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare promovon politika dhe aktivitete, në procesin e përsheptimit të integrimit të Republikës së Kosovës në BE;
7. Bashkërendon, monitoron dhe analizon ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së;
8. Vlerëson pajtueshmërinë e legjislacionit vendor me të drejtën e BE-së;
9. Koordinon përkthimin e legjislacionit të BE-së, për procesin e përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së;
10. Ndihmon dhe bashkërendon mekanizmat përkatës të koordinimit me Donatorë;
11. Në bashkëpunim me institucionet tjera qeveritare, bashkërendon, monitoron dhe kujdeset për harmonizimin e ndihmës së jashtme me agjendën Evropiane dhe zhvillimore të Kosovës;
12. Koordinon punën e Zyrave përgjegjëse për Integrimin Evropian në Ministri si dhe institucionet tjera publike, dhe sipas nevojës ofron ekspertizë dhe ndihmë në përgatitjen e programeve për mbështetje financiare nga BE-ja, si dhe në zbatimin e obligimeve të tyre të cilat rrjedhin nga procesi i Integrimit Evropian;
13. Përgatit dhe bënë nënshkrimin e marrëveshjeve të ndihmave financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Kosovës, në kuadër të programeve të përcaktuara në pikën 14. të këtij vendimi;
14. Bashkërendon, programon dhe monitoron ndihmën e BE-së për Qeverinë e Republikës së Kosovës (programi IPA, TAIEX, si dhe programe tjera të ndihmës, që mund t'i ofrohen Republikës së Kosovës), sipas përparësive të vendit tonë, në kuadër të procesit të Integrimit Evropian;
15. Në bashkëpunim të ngushtë me institucionet tjera përgjegjëse përgatit dhe koordinon procesin e ngritjes së kapaciteteve në fushën e Integrimit Evropian;
16. Bashkërendon hartimin dhe zbatimin e programit për informimin e publikut për çështjet e Integrimit Evropian.

Organizimi dhe strukturimi i Ministrisë së Integrimit Evropian do të rregullohet me Rregullore të propozuar nga ministri i Ministrisë së Integrimit Evropian e cila aprovohet nga Qeveria në afat prej tre muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë